



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:050538

Datë: 05.08.2024

Numri i dokumentit: 06038481

KPPP.nr. 307/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “LINK PLUS IT” SH.P.K., me numër unik të identifikimit 810835142, me seli në Prishtinë, rr. “Pashko Vasa” nr.46, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Lirim Zeka, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 1062/23 të datës 21.12.2023, të Përmbartuesit Privat Irfan I. Kërçagu, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 05.08.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “LINK PLUS IT” SH.P.K., dhe Urdhrit Përmbartimor P.nr. 1062/23 i lejuar me datë 21.12.2023 nga Përmbartuesi Privat Irfan I. Kërçagu, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati i Punës ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 1062/23 të datës 21.12.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm – Vendimit të Inspektoratit të Punës Nr. 01.25-108/2023 të datës 20.06.2023, me të cilin ka urdhëruar debitorin që t’ia paguaj kreditorit në emër të gjobës shumë prej 2,000.00€ (dy mijë euro) me kamatë ligjore duke filluar prej paraqitjes së propozimit për ekzekutim, deri në pagesën përfundimtare, me ndalim të qarkullimit të mjeteve në xhirollogarinë e debitorit dhe llogarive tjera ndihmëse në BPK, ose pasurisë së debitorit deri në bartjen e shumës së cekur më lartë në xhirollogarinë e kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi

urdhrit përbarimor, duke theksuar se Përbaruesi që ka lëshuar urdhrin nuk është kompetent për të vepruar sipas propozimit për përbarim, si dhe propozimi për përbarim është parashtruar nga personi që nuk ka autorizime ligjore për të ndërmarrë një veprim të tillë. Tutje ka shtuar se kryeinspektorati i punës është përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve sa i përket shqiptimit të gjobave, mirëpo në rastin konkret si përfaqësues i kreditorit është paraqitur një person i cili nuk ka autorizime ligjore për ta iniciuar dhe përfaqësuar kreditorin në këtë procedurë, pasi vetëm kryeinspektori i inspektoratit të punës ka të drejtë të inicioj dhe mbikëqyr procedurën e ekzekutimit të vendimit nr.01.25-108/2023 të datës 20.06.2023. Andaj, gjykatës i ka propozuar që të aprovoj në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit, të anuloj Urdhrin Përbarimor P.nr. 1062/23 të datës 21.12.2023 dhe të refuzoj ose ta hedhë poshtë si të palejuar propozimin për përbarim të datës 21.12.2023.

Kreditori brenda afatit ligjorë ka paraqitur përgjigje në prapësim me të cilën ka kundërshtuar pretendimet e debitorit me arsyetimin se të njëjtat janë të pabazuara në dispozitat ligjore. Tutje ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se mungon baza juridike për përbarim pasi që në vendimin Nr.01.25-108/2023 të datës 20.06.2023 mbi shqiptimin e masës ndëshkimore të gjobës në shumën prej 2000€ (dy mijë euro), kreditori i ka vendosur vulat e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë, andaj vendimi me numër Nr.01.25.108/2023 është i besueshëm, i përbarueshëm dhe i ekzekutueshëm. Më tutje ka theksuar se vendimet e Inspektoratit të Punës janë të ekzekutueshme dhe ushtrimi i padisë në konflikt administrativ nuk e ndalë ekzekutimin e vendimit. Andaj, gjykatës i propozon që të refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të lë në fuqi urdhrin përbarimor, P.nr.1062/23, i lejuar me datë 21.12.2023, nga Përbaruesi Privat Irfan I. Kërçagu.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përbarues ka lejuar përbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë*

të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”.

Gjykata ka vlerësuar dokumentin përbarimor Aktvendimin nr.01.25-108/2023 të datës 20.06.2023, në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përbarimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafit 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Po ashtu Aktvendimi nr.01.25-108/2023, i datës 20.06.2023, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi nr.01.25-108/2023 i datës 20.06.2023, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Aktvendimi Nr. nr.01.25-108/2023 i datës 20.06.2023, i nxjerrë nga Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë të datës 12.10.2023.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:050538
Datë: 05.08.2024
Numri i dokumentit: 06038481

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.307/24, datë 05.08.2024

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.